



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



**Kuvendi i Komunës - Gjakovë**

**01 Nr. \_\_\_\_\_ /2020**

**Dt.10.12.2020**

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 shkronja **d** të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dhe në nenin 6 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës, në mbledhjen e mbajtur me dt.10.12.2019, pas diskutimeve lidhur më pikën e 10-të të rendit të ditës: Shqyrtimi Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2020 , e miratoi këtë:

### **V E N D I M** **Për Planin e Punës së Kuvendit**

1. Miratohet Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2021 .
2. Mbledhjet e Komitetit për Politik dhe Financa ( KPF) për vitin 2021 do të mbahen të Enjten e dytë të çdo muaji, gjithashtu mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2021 do të mbahen të Enjten e katërt eventualisht të Enjten e fundit të çdo muaj .
3. Kuvendi i Komunës së Gjakovës në kuadër të aktiviteteve vjetore do të organizojë vizita bashkëpunimi në institucione dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare .
4. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2021 .
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
6. **Vendimi iu dërgohet:**
  - Kryetarit të Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini.
  - Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.
  - Drejtorive Komunale
  - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës.
  - Arkivit .



**Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021**  
**Rendi i ditës**

	Informatë e Kryetarit mbi Planin e Punës së Ekzekutivi për vitin 2021
	Raporti i Kryetarit mbi gjendjen ekonomiko-financiare dhe zbatimi i planeve Investuese në komunën e Gjakovës për vitin 2020
	Shqyrtimi i progresit të adresimit të rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas planit të veprimit të ekzekutivi komunal
JANAR 2021	Miratimi i Planit të punës së KKS-së 2021
	Informatë mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror .
SHKURT 2021	Shqyrtimi i Raportit të Auditorit dhe i raportit të punës për tre (3) ndërmarrjet Publike Komunale për vitin 2020
	Informatë mbi realizimin e Planit Vjetor të punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2020
	Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Shqyrtimi i Raportit final financiar të Komunës së Gjakovës për vitin 2020
	Bartja (rialokimi) i buxhetit të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual
MARS 2021	Raporti vjetor i punës i Zyrës së Personelit për vitin paraprak 2020
	Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Shqyrtimi i informates financiare të Komunës së Gjakovës për periudhën Janar – Mars 2021
	Informatë mbi ndriqimin publik në Komunën e Gjakovës
PRILL 2021	Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Gjakovës
	Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Informatë mbi përgatitjet ndaj emergjencave në Komunën e Gjakovës
	Informatë mbi Qarkoren e parë të Ministrisë së Financave
MAJ 2021	Informatë mbi përgatitjet për mirëmbajtjen verore të rrugëve në Komunën e Gjakovës
	Informata mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre .
	Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal

<b>QERSHOR 2021</b>	<p>Miratimi i Kornizës Aftimesme Buxhetore (KAB) 2022-2025</p> <p>Rishikimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2021</p> <p>Informatë mbi gjendjen e sigurisë në Komunën e Gjakovës</p> <p>Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSb-së në Komunën e Gjakovës</p> <p>Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal</p>
<b>KORRIK 2021</b>	<p>Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Gjakovës për vitin 2020</p> <p>Raport mbi përfundimin e vitit shkollor 2020-2021 në Komunën e Gjakovës .</p> <p>Raport i Kryetarit për situatën ekonomiko-financiare të Komunës së Gjakovës dhe zbatimi i planeve investuese të komunës për periudhën Janar-Qershor 2021</p> <p>Shqyrtimi i informates së II financiare të Komunës së Gjakovës për periudhën Janar – Qershor 2021</p> <p>Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal</p>
<b>GUSHT 2021</b>	<p style="text-align: center;"><b>PUSHIM</b></p>
<b>SHTATOR 2021</b>	<p>Shqyrtimi dhe miratimi i normës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022</p> <p>Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës së Gjakovës për vitin 2022</p> <p>Informatë mbi përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor në Komunën e Gjakovës 2021-2022</p> <p>Informatë mbi përgatitjet për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve në Komunën e Gjakovës</p> <p>Shqyrtimi i informatës së III financiare të Komunës së Gjakovës për periudhën Janar – Shtator 2021</p> <p>Informatë mbi ndajjen e subvencioneve Janar - Shtator 2021</p> <p>Informatë mbi implementimin e Planit për Investime në Hapësirat e Hapura Publike në Komunën e Gjakovës</p> <p>Informatë mbi implementimin e Planit për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Gjakovës</p> <p>Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal</p>
<b>TETOR 2021</b>	<p>Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal</p>

NENTOR 2021
Informatë e përgjithshme për zhvillimin e bujqësisë në Komunën e Gjakovës
Raporti i Punës së Komitetit për Komunitete
Informatë mbi gjendjen e sigurisë në Komunën e Gjakovës
Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
Shqyrtimi i Raportit të Punës nga Zyra e Prokurimit për vitin 2020. Informatë mbi kontratat komizë të Komunës së Gjakovës
Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSBS-së
Miratimi i Planit të punës së KKSBS-së 2022
Informatë mbi realizimin e Planit Vjetor të punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2021
Shqyrtimi i Raportit të Auditorit dhe i raportit të punës për tre (3) ndërmarrjet Publike Komunale për vitin 2021
Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal

**DHJETOR 2021**